

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “ HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

Studime Master - Drejtimi Civil dhe Pronësor

Kandidatja : Lorika Kabashi

Mentori : Prof. Ass. Dr. Qerkin Berisha

Titulli i temës : Definimi i të drejtave pronësore në pronën e paluajtshme shoqërore dhe në pronën publike

ABSTRAKT

Qëllimi i këtij punimi është trajtimi dhe analizimi i njërit nga institutet më të rëndësishme të së drejtës civile siç është pronësia.

Përmes këtij punimi trajtohen në mënyrë të hollësishme definimi dhe llojet e pronësisë, procesi dhe fazat e krijimit të pronësisë shoqërore dhe analizimi i të drejtave pronësore në pronën e paluajtshme shoqërore dhe publike si dhe kufizimet e autorizimeve themelore në këto prona si bazë kryesore e këtij punimi të diplomës.

Bazuar në kornizën ligjore aktuale të drejtat mbi pronën private janë të përcaktuara qartë, mirëpo sa i përket llojeve tjera jo private të të drejtave ka shumë diskutime dhe paqartësi. Andaj në këtë punim jepet një analizë e detajuar sa i përket rëndësisë që ka definimi i të drejtave pronësore në pronën e paluajtshme publike dhe shoqërore në sistemin tonë juridik, me qëllim të ndërtimit të një kornize ligjore e cila garanton qartësi juridike.

Njohja e të drejtave pronësore në pronën e paluajtshme publike dhe shoqërore na bënë të kuptojmë rëndësinë e definimit të këtyre të drejtave përmes analizës së legjislacionit në fuqi të cilat vënë në pah rëndësinë e definimit të këtyre të drejtave.

Fjalet kyçe: Pronësia, llojet e pronësisë, definimi i llojeve të pronësisë, të drejtat pronësore mbi llojet e pronës.